VENDIM
Nr.314, datë 12.3.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA RRASHBULL TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Rrashbull të qarkut të Durrësit, që do t'i transferohen në pronësi kësaj njësie.
2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 12 (dymbëdhjetë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Rrashbull për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU

Komuna: **Rrashbull**

Nr. ren.	Nr. i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK), shtrirja gjeografike e EPK-së	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1.	63	Bozanxhie	Bozanxhie	26b	Boshe	14.5		MMPAU	DSHP Durrës	
2.	64	Shkallnuer	Pylli i Vargjeve	27	Pyll prodhues	5	Dru zjarri	MMPAU	DSHP Durrës	
3.	65	Shkallnuer	Pylli i Kertecit	28a	Pyll prodhues	7.5	Dru zjarri	MMPAU	DSHP Durrës	
4.	66	Shkallnuer	Pylli i Kertecit	28b	Boshe	1.5		MMPAU	DSHP Durrës	
5.	67	Shijak Maminas	Faqja Prroit Madh	4	Kullotë	23.1	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	Kaluar me VKM nr.700, datë 23.10.95
6.	68	Romanat	Gryka e Skiles	5	Kullotë	49.8	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	
7.	69	Manskuri	Kodra Dushkut	6	Kullotë	57.8	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	
8.	70	Manskuri(lagjja Veze)	Djerri Prroit Madh	7	Kullotë	55.2	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	
9.	71	Manskuri(lagjja Gjuzaj)	Faqja Gjuzaj	9	Kullotë	44.4	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	
10.	72	Shkallnuer(lagjja Vargje)	Shkallmuer	10	Kullotë	85.7	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	
11.	73	Shkallnuer	Faqja Memaj	11	Kullotë	49	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	
12.	74	Manskuri(lagjja Tusha)	Faqja Memaj	12	Kullotë	72.7	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	

Njësia e qeverisjes vendore: Rrashbull

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
63-74	Pyll, kullotë	Pronësi